

# E drejta e informimit në bankoprovë

Ligji i ri për të drejtën e informimit, i miratuar në fund të vitit 2014, erdhi si një risi tepër e rëndësishme, duke synuar rritjen e transparencës së qeverisë dhe marrjen e informacionit shumë më shpejt.

Por, a funksionon kështu ky ligj? Si ka funksionuar ai në praktike gjatë vitit të parë pas miratimit? Cilet problemesh janë hasur gjatë vitit të parë? A ka nevojë një ligj kështu i ri për amendamente dhe nëse po, ku duhet ndërhyrë? Cilet janë autoritetet që e zbatojnë dhe cilet e shpërfillin?

Qendra Res Publica, me mbështetjen e Civil Rights Defenders, gjatë vitit 2015 ka bërë një testim të ligjit të ri në shumë mënyra dhe gjetjet e rekomandimet janë përmbledhur në publikimin me titull “E drejta e informimit në bankoprovë”. Pas prezantimit të tij më 4 Dhjetor 2015, Res Publica ka vënë në dispozicion të çdo personi të interesuar një kopje elektronike të raportit ([kliko këtu](#)).

Res Publica